



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 DHOMA E NOTERISE TIRANE
 NR. 2528 Rep.
 Nr. 247 Kol.

KONTRATE SHITBLERJEJE

Sot, me date .11.2000 (dymije) para meje noteres , u paraqiten personalisht palet kontraktuese me cilesite e meposhtme;

SHITESI: Skender Halilaj, i biri i Basriut, dtl. 1944, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike te vepruar; me pasaporte 0275564.
 BLERESI: Alfons Uka, i biri i Dedes, dtl. 1965, banues ne Tirane, rruga N.Manastiri, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr.0207243.

te cilet kerkuan te lidhet kontrata e shitblerjes si me poshte :

Me vendimin nr.23432, date 21.03.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar MAK OLIMP SHPK eshte me ortak Alfons Uka dhe Skender Halilaj, me administrator Alfons Uka , me seli ne Tirane me kapital themeltar 100.000 leke.

Me vendimin nr.1 te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te dates 20.11.2000 u pranua kerkesa per largimin me deshiren e tij z. Skender Halilaj nga kjo shoqeri dhe ne baze te kontrates se shitblerjes transferohen te gjitha kuotat e tij me 50 % kundrejt shumes 50.000 leke Alfons Uka.

Me blerjen e kuotave nga ortaku Skender Halilaj, ortaku qe mbetet Alfons Uka tani zoteron 100 % kuota te barabarta me 100.000 leke, pra kjo shoqeri mbetet me ortak e administrator te vetem Alfons Uka .

Ortaku qe largohet Skender Halilaj deklaron se ia shet me vullnetin e tij te lire dhe te plote kuotat Alfons Uka qe zoteron tani mbas blerjes ne shoqerine MAK OLIMPIK SHPK 100.000 leke ose nga 100 % kuota .

Ortaku qe largohet skender Halilaj zhvishet nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kane pasur ne kete shoqeri. Kontrata mbasi u lexua gje u gjet sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote nenshkruhet rregullisht prej tyre para meje noteres dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.---

PALET

SHITESI
 SKENDER HALILAJ

BLERESI
 ALFONS UKA



*Notere
 Hatirho Gajani*

